



**Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Drejtoria për Statistikë**

Shkup, 28 qershor 2024

Njoftim për shtyp

Zhvillimet më të rëndësishme në normat e interesit të bankave dhe kursimoreve¹: maj, 2024

- Norma mesatare e interesit të totalit të kredive në maj të vitit 2024 shënoi 5,49% dhe në bazë mujore është zvogëluar për 0,02 p.p., me rritje vjetore prej 0,40 p.p. Norma mesatare e interesit të totalit të depozitave shënoi rritje mujore dhe vjetore prej 0,04 p.p. dhe 0,64% p.p., respektivisht dhe shënon 1,86%.
- Këtë muaj, norma mesatare e interesit të kredive të reja² shënon 5,19% dhe shënoi rënie mujore dhe vjetore prej 0,28 p.p. dhe 0,13 p.p., respektivisht. Norma mesatare e interesit të depozitave të reja shënoi 2,36% dhe në bazë mujore është zvogëluar për 0,18 p.p., në kushte të rritjes vjetore prej 0,43 p.p.

Tabela 1. Normat e interesit të depozitave dhe kredive të reja në total

	5.2023	6.2023	7.2023	8.2023	9.2023	10.2023	11.2023	12.2023	1.2024	2.2024	3.2024	4.2024	5.2024
në % në bazë mujore													
Totali i kredive	5.09	5.12	5.49	5.49	5.49	5.49	5.48	5.47	5.55	5.52	5.50	5.51	5.49
Korporatat	4.81	4.86	5.36	5.36	5.37	5.37	5.36	5.33	5.44	5.40	5.65	5.35	5.31
Amviseritë	5.34	5.35	5.61	5.61	5.61	5.60	5.59	5.59	5.65	5.64	5.35	5.65	5.65
Kreditë e reja	5.32	5.26	5.57	5.53	5.49	5.55	5.38	5.21	5.22	5.35	4.98	5.47	5.19
Korporatat	5.36	5.26	5.75	5.73	5.50	5.71	5.39	5.30	5.21	5.25	5.40	5.57	5.16
Amviseritë	5.25	5.27	5.32	5.24	5.47	5.28	5.35	5.02	5.26	5.45	4.73	5.33	5.26
Depozitat	1.22	1.40	1.50	1.55	1.59	1.67	1.74	1.79	1.72	1.76	1.80	1.82	1.86
Korporatat	1.92	1.99	2.02	2.08	1.94	1.96	2.23	2.06	2.07	2.08	1.76	2.11	2.21
Amviseritë	1.15	1.34	1.44	1.50	1.55	1.64	1.69	1.76	1.69	1.73	2.12	1.79	1.81
Depozitat e reja	1.93	2.70	2.21	2.17	2.15	2.32	2.28	2.37	2.22	2.31	2.46	2.54	2.36
Korporatat	1.50	2.11	1.57	1.81	1.65	1.51	1.71	2.19	2.02	2.19	2.42	2.61	2.38
Amviseritë	2.18	2.87	2.40	2.32	2.40	2.57	2.46	2.42	2.30	2.35	2.52	2.52	2.36

Burimi: BPRMV.

¹Me termin "normë interesi" nënkuptohet normë e ponderuar mesatare e interesit e shprehur në përqindje në bazë vjetore. Për shpjegim më të hollësishëm shih Metodologjinë

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia_MIR_07_2018_mak.pdf


² Lidhur me normat e interesit të kredive të reja / depozitat e reja janë karakteristike zhvillime të ndryshueshme. Zhvillimet e këtyre normave të interesit janë si rezultat i ndryshimeve në vëllimin e depozitave/kredive të reja (të cilat nga muaji në muaj mund të ndryshojnë konsiderueshëm), si dhe nga norma e rënë dakord e interesit.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

1. Norma të interesit në sektorin korporativ³


- Norma mesatare e interesit të totalit të kredive të sektorit korporativ, në maj të vitit 2024 shënoi rënie mujore prej 0,04 p.p. dhe arriti në 5,31%. Rënia është rezultat i normave të reduktuara të interesit të të gjitha komponentëve dhe atë: normat e interesit të kredive në valutë të huaj (për 0,06 p.p.) dhe normat e interesit të kredive në denarë pa dhe me klauzolë valutore (për 0,05 dhe 0,03 p.p., respektivisht). Analizuar në bazë vjetore, norma e interesit mesatare të totalit të kredive të sektorit korporativ shënoi rritje prej 0,50 p.p.




Burimi: BPRMV.



- Norma e interesit e kredive të reja të sektorit korporativ, këtë muaj, shënon 5,16% dhe në bazë mujore është zvogëluar për 0,41 p.p. Ndryshimi në rënie është nga normat e interesit të kredive në denarë me klauzolë valutore, gjatë rritjes së normave të interesit në valutë të huaj dhe të normave të interesit të kredive në denarë pa klauzolë valutore (për 0,08 p.p. dhe 0,07 p.p., respektivisht). Në krahasim me muajin maj të vitit të kaluar, kjo normë e interesit është zvogëluar për 0,20 p.p.



Burimi: BPRMV.




³ Për nevojat e këtij njoftimi, sektori korporativ përfshin institucionet jo-financiare (publike dhe të tjera).




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Te norma mesatare e interesit për totalin e depozitave të sektorit korporativ, në maj, është vërejtur rritje mujore prej 0,10 p.p. dhe shënon 2,21%. Ndërkohë, ndryshimi është si rezultat i rritjes të normave të interesit të depozitave në valutë të huaj (për 0,36 p.p.) dhe të normave të interesit të depozitave në denarë me klauzolë valutore (për 0,02 p.p.), ndërsa normat e interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore janë të pandryshuara. Në bazë vjetore, kjo normë e interesit shënon rritje prej 0,29 p.p.
- Ky muaj, norma e interesit e depozitave të reja⁴ të sektorit korporativ është 2,38% dhe është zvogëluar për 0,23 p.p. Ndryshimi është rezultat i rënies së normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore (për 0,21 p.p.), me rritje të normave të interesit të depozitave në denarë me klauzolë valutore dhe të normave të interesit të depozitave në valutë të huaj (për 0,40 p.p. dhe 0,33 p.p., respektivisht). Rritja vjetore e normave të interesit të depozitave të reja të sektorit korporativ është 0,88 p.p.

2. Norma të interesit për amvisëritë⁵



Burimi: BPRMV.





- Në maj, norma e interesit e totalit të kredive të amvisërive është 5,65% dhe në bazë mujore është e pandryshuar. Krahësuar në bazë vjetore, kjo normë e interesit është rritur për 0,31 p.p.
- Norma mesatare e interesit të kredive të reja të amvisërive, këtë muaj, realizoi rënie mujore prej 0,07 p.p. dhe shënon 5,26%. Ndryshimi në rënie është rezultat i rënies të normave të interesit të kredive në denarë pa dhe me klauzolë valutore (për 0,11 p.p. dhe për 0,03 p.p., respektivisht) në kushte kur normat e interesit të kredive në valutë të huaj janë rritur (për 0,27 p.p.). Krahësuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar, kjo normë e interesit është rritur për 0,01 p.p.

⁴ Në grafikun që i referohet normave të interesit për depozitat e reja të sektorit korporativ, ndërprerja në seritë e të dhënave të normave të interesit në denarë me klauzolë valutore është si rezultat i asaj që në muaj të caktuar bankat dhe kursimoret nuk kanë pranuar lloj të atillë të depozitave nga sektori korporativ.

⁵Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë përfshijnë: persona fizik, ekzekutues të pavarur të veprimtarisë dhe institucione jofitimprurëse të cilët u shërbejnë amvisërive.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë



Burimi: BPRMV.

- Ky muaj, norma e interesit e totali të depozitave të amvisërive, është 1,81% dhe në nivel mujor është rritur për 0,02 p.p. Rritja mujore është si rezultat i normave më të larta të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore dhe të depozitave në valutë të huaj (për 0,03 p.p. dhe 0,01 p.p., respektivisht), ndërsa normat e interesit të depozitave në denarë me klauzolë valutore janë reduktuar (për 0,03 p.p.). Në bazë vjetore, kjo normë e interesit është rritur për 0,66 p.p.
- Norma e interesit të depozitave të reja të amvisërive⁶, në maj, është 2,36% dhe është ulur për 0,16 p.p. krahasuar me muajin paraprak. Analizuar sipas valutave, ndryshimi mujor është rezultat i rënies së normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore dhe të depozitave në valutë të huaj (për 0,22 p.p. dhe 0,08 p.p., respektivisht). Në maj, bankat dhe kursimoret nuk kanë regjistruar depozita të reja në denarë me klauzolë valutore. Norma e interesit e depozitave të reja të amvisërive është më e lartë për 0,18 p.p. krahasuar me muajin maj të vitit të kaluar.

⁶ Në grafikun që u referohet normave të interesit të depozitave të reja të amvisërive, ndërprerja e serive e të dhënave në normat e interesit në denarë me klauzolë valutore është për shkak të faktit që në muaj të caktuar bankat dhe shtëpitë e kursimit nuk kanë pranuar depozita të amvisërive të këtij lloji.



**Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Drejtoria për Statistikë**

Informacione shoqëruese

Të dhënat e serive kohore: të dhëna vjetore, tremujore dhe mujore për normat e ponderuara të interesit të bankave dhe kursimoreve

http://www.nbrm.mk/statistika_na_kamatni_stapki.nspix

Shpjegime metodologjike:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologija/Metodologija_MIR_07_2018_mak.pdf

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimit të të dhënave

http://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_na_objavuvanje_podatoci.pdf

Të dhëna mujore për normat e interesit: 31 korrik 2024 (mesatare referuese duke përfshirë edhe qershorin 2024).

Për pyetje gazetarësh, ju lutemi kontaktoni me personat e Kabinetit të Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme në lidhje me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit lokal 02/3215-235). 108/110.